



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 227/12 Prot.

Vlorë, më 29.01.2020

VENDIM

Nr. 51, datë 29.01.2020

**PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT
"MASTER NË MËSUESI PËR HISTORI-GJEOGRAFI"**

Mbështetur në nenin 75, pikën 7 të nenit 25, shkronjën **dh**, pika 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin nr. 1, datë 14.01. 2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.01.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Edukimit për program të ri studimi të ciklit të dytë "Master në mësuesi për histori-gjeografi".
2. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

